

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **622-25-1796-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Dezinsektimi dhe deratizimi i qytetit të Prizrenit dhe zonave periferike Kontrat Kornize 2 vjeqare**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K.
NUI	811498957
Adresa	Taslixhe II
Vendi	PRISHTINË
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	044158638
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Lulzim Katanolli
Adresa elektronike	info@doctorexterminator.com
Data e parashtrimit të ankesës	02.07.2025

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Dezinsektimi dhe deratizimi i qytetit të Prizrenit dhe zonave periferike Kontrat Kornize 2 vjeqare

B05 Njoftim per Kontrat 12.03.2025 14:35

B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara 17.03.2025 14:48

B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara 26.03.2025 14:46

B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara 03.04.2025 15:36

B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara 11.06.2025 13:36

Template per Dosja e Tenderit (Shqipe) (4) (4).Doc 26.03.2025

Template per Dosja e Tenderit (Shqipe) (4) (4) (1).Doc11.06.2025 13:35

02.04.2025 14:50 Kërkesë për rishqyrtim - Kerkese per Rishqyrtim (10).Pdf

03.04.2025 15:35 1796 VENDIMI TRULY NOLEN.docx

Vendimi i OSHP: 2025/0257 i dates 09/06/2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Në lidhje me këtë çështje, ofrojmë si provë vendimin e Autoritetit Kontraktues

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e “DOCTOR EXTERMINATOR DDD” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:

Dezinsektimi dhe deratizimi i qytetit të Prizrenit dhe zonave periferike Kontrat Kornize 2 vjeqare Me nr të Prokurimit : 622-25-1796-2-2-1 të parashtruar kundër njoftimit për kontratë të AK –së, të datës 12. 03. 2025 të publikuar në web-faqe të KRPP-së

Shtyhet afati për hapjen e ofertave për datën 08. 07. 2025 në ora 14:00

A r s y e t i m

“DOCTOR EXTERMINATOR DDD” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Dezinsektimi dhe deratizimi i qytetit të Prizrenit dhe zonave periferike Kontrat Kornize 2 vjeqare Me nr të Prokurimit : 622-25-1796-2-2-1

Autoriteti Kontraktues, me dat. 26. 06. 2025 , ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka vendosë që kërkesa juaj për rishqyrtim është e pa bazuar për arsyet në vijim:

Në procesin e rishqyrtimit të kërkesës tuaj, janë trajtuar të gjitha pretendimet tuaja të ngritura dhe që të gjitha janë vlerësuar si të pabazuara.

Kjo procedurë ka qenë objekt shqyrtimi në OSHP dhe ky organ me vendimin nr OSHP: 2025/0257

Ka kërkaur nga Autoriteti kontraktues si vijon:

Anulohet njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Dezinsektimi dhe deratizimi i qytetit të Prizrenit dhe zonave periferike Kontratë Kornize 2 vjeqare”, me numër të prokurimit 622-25-1796-2-2- 1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA E PRIZRENIT”, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim

Komuna e Prizrenit ka vepruar sipas këtij VENDIMI, ka bërë korrigjimin e procedurës me formularin B54, ka bërë shtyerjen e afatit të hapjes së ofertave dhe deri me datë 24. 06. 2025 nuk ka pas reagime nga asnjë OE por në moment shfaqeni ju me një mori kërkesash e vërejtjesh të cilat edhe sipas Autoritetit kontraktues e rrjedhimisht edhe sipas OSHP së janë të paqëndrueshme

Andaj duke pas parasyshë argumentet e dhëna më lartë

1. Autoriteti Kontraktues, vendos si në dispozitivin e këtij vendimi

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 6 LPP Proporcionaliteti

Neni 7 LPP Trajtimi i barabartë

Neni 28.4 dhe 28.7 LPP Specifikimet teknike dhe barazia teknike

Neni 65 LPP Kapacitetet dhe kriteret për OE

Neni 108/A LPP Detyrimi për arsyetim të vendimit

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjabë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejtshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I. Objekti i Ankesës

Përmes kësaj anese, kërkojmë që OSHP-ja të shqyrtojë në mënyrë të thelluar ligjshmërinë e vendimit të Autoritetit Kontraktues të datës 26.06.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Dezinsektimi dhe deratizimi i qytetit të Prizrenit dhe zonave periferike Kontratë Kornizë 2 vjeçare, dhe të vendosë sipas ligjit për të garantuar barazi në trajtim, konkurrencë të ndershme dhe zbatim të plotë të parimeve të LPP-së, si dhe të urdhërojë korrigjimin e të gjitha parregullsive të konstatuara.

II. Arsye e zgjeruar e Ankesës

1 Moszbatim i plotë i vendimit të mëparshëm të OSHP-së

Vendimi paraparak i OSHP-së nr. 2025/0257 ka urdhëruar qartë:

Të bëhen përmirësimet në dosje të tenderit, duke përfshirë: largimin e kriterëve

joproporcionale, diskriminuese dhe përjashtuese, si dhe përfshirjen e formulimit 'ose ekuivalent në specifikimet teknike. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues ka bërë ndryshime sipërfaqësore: termi ose ekuivalent figuron vetëm pjesërisht, tek përshkrimi i dezinfektuesit, ndërsa mungon krejtësisht tek kriteret tjera të Dosjes së Tednerit.

Ky moszbatim përbën mosrespektim të drejtëpërdrejtë të një vendimi të formës së prerë të OSHP-së, duke e bërë të pakuptimtë procedurën e rivlerësimit të tenderit. Moszbatimi i vendimeve të OSHP-së çënon rendin juridik të prokurimit publik dhe krijon precedent të rrezikshëm që Autoritetet Kontraktuese të mos respektojnë vendimet e organeve të pavarura mbikëqyrëse.

2. Specifikime teknike diskriminuese dhe orientuese

Specifikimet aktuale për pajisjet dhe preparatet:

përputhen fjalë për fjalë me karakteristikat teknike të një prodhuesi të vetëm (IGEBAGmbH); shih linkun <https://igeba.de/en/>

përjashtojnë produkte të tjerë të barasvlershëm nga prodhues të njohur ndërkombëtarisht si Curtis DynaFOG, B&G, ADAPCO, Guardian etj.;

kufizojnë konkurrencën duke imponuar parametra jashtëzakonisht të ngushtë si: vëllime fiks rezervuarësh, sisteme rrotulluese 360°, lloje specifike filtrash, telekomandë kabine etj.

Ky formulim bie ndesh me Nenin 28.4 të LPP-së, i cili ndalon specifikimet që kufizojnë origjinën, prodhuesin ose burimin, përveç rasteve kur ka arsye të argumentuara shëndetësore ose teknike. Po ashtu, sipas Nenin 28.7 të LPP-së, kur përmendet një markë, model ose karakteristikë specifike, duhet patjetër të shoqërohet me termin ose ekuivalent për të garantuar barazi teknike.

AK nuk ka dhënë asnjë arsye teknike të arsyetuar përse parametra kaq të ngushtë dhe të lidhur me një prodhues janë të domosdoshëm për objektin e kontratës. Ky favoritizim i drejtëpërdrejtë shkel gjithashtu Nenin 7 (trajtim i barabartë) dhe Nenin 6 (parimi i proporcionalitetit) të LPP-së.

2.1 Gjuha jo profesionale dhe cenimi i së drejtës për ankesë

Në arsyetimin e vendimit, AK përdor formulimin:

...dhe deri me datë 24.06.2025 nuk ka pas reagime nga asnjë OE, por në moment shfaqeni ju me një mori kërkesash....

Ky formulim është denigrues, paragjykues dhe cenon qartë të drejtën e OE-ve për të ushtruar mjetet juridike brenda afateve ligjore të garantuara me Nenin 108/A të LPP-së dhe nenet për Rregullat për Parashtrimin e Ankesave të KRPP-së.

Ligji nuk kufizon momentin kur një operator ekonomik mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim, për sa kohë është brenda afatit. Përdorimi i fjalëve si shfaqeni ju shfaq një qëndrim subjektiv dhe paragjykues nga një organ që, sipas ligjit, duhet të jetë i paanshëm dhe objektiv në trajtimin e çdo kërkesë.

Kërkesa të panevojshme, të tepruara dhe joproporcionale

Dokumentacioni i tenderit mban ende kërkesa që nuk lidhen drejtëpërdrejt me natyrën e shërbimit:

Angazhimi i Inxhinierit Sanitar, i cili është i panevojshëm pasi shërbimet DDD

(dezinfektim, dezinfektim, deratizim) mbulohen nga Epidemiologu dhe Ekologu, profesionistë të cilët janë më adekuatë dhe të përcaktuar sipas praktikave të OBSH-së. Kërkesa për raport rishqyrtimi për kompaninë, që është një kriter i panevojshëm për një shërbim standard operacional.

Detyrimi për Certifikatë Analize jo më të vjetër se 6 muaj për produkte që kanë afat përdorimi 3-10 vjet dhe janë të autorizuar nga organet shëndetësore.

Origjina vetëm BE, pa argumentim teknik, përjashton produkte të certifikuara ndërkombëtarisht dhe bie ndesh me Nenin 28.4 LPP.

Kërkesa për Deklaratë Konformiteti CE për substanca kimike, e cila nuk aplikohet sipas rregulloreve të BE-së për biocidet (Regullorja nr. 528/2012).

Këto kërkesa tejkalojnë proporcionalitetin dhe bien ndesh me Nenin 6 LPP dhe Nenin 65 LPP, pasi nuk janë të lidhura realisht me objektin e kontratës dhe rrisin padrejtësisht barrën për operatorët ekonomikë.

Mungesë arsytimi ligjor dhe teknik

Vendimi i AK-së nuk ofron asnjë analizë konkrete, as për një pikë të vetme të pretendimeve tona.

Kjo bie ndesh me Nenin 108/A LPP, i cili e obligon AK-në që, kur merr një vendim për një kërkesë për rishqyrtim, të arsyetojë qartë dhe të argumentojë secilën pikë. Vetëm një fjali se pretendimet janë të pabazuara nuk përbën arsyetim ligjor, por formalitet administrativ pa mbështetje faktike apo ligjore.

Kërkesa konkrete

Në bazë të fakteve të paraqitura, kërkojmë që OSHP-ja:

Të shqyrtojë këtë ankesë në thelb;

Të konstatojë të gjitha shkeljet ligjore të mësipërme;

Të urdhërojë Autoritetin Kontraktues të bëjë korrigjimin e plotë të dokumentacionit të tenderit, duke përfshirë formulimin ose ekuivalent në të gjitha pikat ku është i detyrueshëm;

Të heqë të gjitha kriteret e panevojshme dhe të pajustificuara që nuk lidhen realisht me objektin e kontratës;

Të urdhërojë zgjatjen e arsyeshme të afatit të ofertimit, në mënyrë që të mundësohet konkurrencë reale, e hapur dhe trajtim i barabartë.

Shtojca:

Kërkesa për rishqyrtim (24.06.2025)

Vendimi i AK-së (26.06.2025)

Vendimi i OSHP-së nr. 2025/0257

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Bllokim i kapaciteteve teknike dhe njerëzore për një periudhë të gjatë.

Kosto të humbura për shkak të kufizimit të konkurrencës.

Dëmtim i reputacionit si kompani konkurruese në tregun publik.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*